




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale; ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,

th e r r e t

mbledhjen e **tretë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **10.05.2017**, dhe do të fillojë në orën **15:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Këshillit të Drejtorëve (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbalit të mbledhjes së parë dhe të dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Diskutim lidhur me raportin tremujor financiar, janar - mars 2017;
3. Bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetjake nga viti 2016 në vitin 2017;
4. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me prona të paluajtshme të personave fizikë;
6. Propozimvendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objekteve shumëbanesore, parcelat: 1180-1, 1185-1, 1183-2, 1184-1, 1178-0, 1177-0, 1179-0 dhe 1176-0K Bernicë e Epërme.
7. Propozimvendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e depos, ku do të trajtohen mbetjet e materialeve ndërtimore, parcela 19-0, ZK Drenoc.
8. Propozimvendimi për lënie në dispozicion të Projektplanit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje";
9. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1";
10. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20 - lagjja "Mati 1" 2017 - 2025;
11. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë N.P.L. "Hortikultura".
12. Miratimi i Rregullores për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës;
13. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

KRYESUESI I KOMITETIT
Halim Halimi, jur. i dipl.

